



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:052823

Datë: 07.05.2019

Numri i dokumentit: 00304087

P.nr.1020/2016

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, çështjen penale kundër të akuzuarit B.B, me vendbanim në rrugën ... në Ferizaj, nr...., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.279-7/16 i datës 20.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor-fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuari, me dt.12.09.2018, solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.B, me vendbanim në rrugën në Ferizaj , i lindur me ... nga i ati E... dhe nëna T... e vajzërisë D..., shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer katër vite te shkollës fillore, prindër i katër fëmijëve ,i pa punë , me numër personal

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

- prej datës së pa vërtetuar e deri me datën 23.12.2015me rastin e kontrollës nga punëtoret e KEDS-it të njësoveve të energjisë elektrike, në atë mënyrë qe konsumatori ka bere ndërhyrje te paautorizuar ne njësor elektrik ashtu që është kyçur direkt ne kabllon furnizuese para njësorit elektrik me një kabull 2x4 dhe si pasoje e kësaj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar ne njësorin elektrik, këtë konsumatori e ka bërë me qëllim që vetes ti sjell përfitime materiale në shumën prej 318.07 €uro,-

-Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51 dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së e

G J Y K O N

Të akuzuarit B.B, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej100 /njëqind / €uro, dhe denim me burg prej 3 (tre) muajve, të dy dënimet me kusht, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti paguaj dëmin e shkaktuar në shumë prej në shumë prej 318.07 €uro, këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata bazuar në nenin 453 paragrafi 4 të KPPRK-së të akuzuarin B.B e ka liruar nga detyrimi i pagesës së paushallit gjyqësor dhe nga pagesa e taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit, pasi pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen material të tij dhe është i gjendjes jo të mire shëndetësore

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.279-7/2016 e dt.20.10.2016 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin B.B, me vendbanim në rrugën nr....., në Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt15.11.2016, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Shukri Jashari.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën dhe pasi që gjyqtari është bindur se e njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, i ka afruar mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B.B, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza dhe është e vërtet se është kyçur direkt në kabllon furnizuese para njëorit elektrik pasi që punëtorët e KEDS-it i kishin ndërprerë furnizimin me energji elektrike ku nuk kishte mundësi që ta paguante, kishte pasur bashkëshorten të sëmurë ku për shërim e ka dërgua edhe jashtë shtetit i ka vdekur, ku edhe vetë nuk është mirë me shëndet ku ka patër edhe intervenime mjekësore e për këtë gjykatës i ofron dëshmi që ti ketë në shkresat e kësaj lënde penale, është here e parë që ndeshem me ligjin kërkoj nga gjykate që gjatë shqiptimit të dënimit ti merr parasysh theksimet e cekuar me larë dhe të më shqiptojë një sanksion penale sa më të butë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë komform ligjit dhe provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta pranoj si të tillë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se e pandehura pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në procesverbalin me nr.1203065 i dt.23. 12. 2015,fatura me numër DFE15HP11650, e datës 24.12.2015 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të neneve 73 dhe 74 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale që akuzohet, ka premtuar se më nuk do të përsëris veprime të tilla, ,gjendjen jo të mirë shëndetësore, si dhe atë ekonomike, moshën e tij, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre, i shqipton dënimin si në diapozitiv të aktgjykimit, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të pandehurës dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata bazuar në nenin 453 paragrafi 4 të KPPRK-së të akuzuarin A.Sh, e ka liruar nga detyrimi i pagesës së shpenzimeve të procedurës penale dhe nga pagesa e taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin, pasi pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen material të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht, bazuar edhe në raporteve specialistike.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti kompensoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 318.07 Euro.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1020/2016 me datë 20.10.2016

Zyrtare ligjore.
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.